
 Republika e Kosovës Republika Kosovo	ZYRA E PERSONELIT KANCELARIJA OSOBLJE		 Komuna e Istogut Opština Istok
	02 Nr 307/ 2022	Datë 28.12.2022	

Në bazë të nenit 79 dhe 80, të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr. 06/L-114 dhe nenit 7 të Rregullores (QRK) Nr.05/2022 Për Procedurat Konkurruese dhe Pranimi për Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës, Komuna e Istogut shpall :

K O N K U R S

Titulli i vendit të punës: Pastruese në Objektin e Komunës

Institucioni: Komuna e Istogut

Drejtoria: Drejtoria për Administratë Komunale

Numri i pozitave : 2 (dy)

Titulli i Mbikëqyrësit: Udhëheqësi i Sektorit Administrativ

Grada/Koeficienti: Koeficienti 4

Orët e Punës: 40 orë në javë

Periudha e Kontratës: Në kohë të pacaktuar

Kohëzgjatje e periudhës provuese: Gjashtë (6) muaj

Përshkrimi i detyrave dhe Pëgjegjësi:

1. Kujdeset për mirëmbajtjen e higjenës në kuader të ndertesës së Komunës;
2. Kujdeset për mirëmbajtjen e zyreve në komunë;
3. Kujdeset për mirëmbajtjen e zyrave ndihmëse të QKRC;
4. Kryerja e punëve në bazë të kërkesave të mbikëqyrësit .

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë për konkurim - punësim kanë të gjithë personat e moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgaditjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë për kryerjen e detyrave të punës.

Kualifikimi profesional, aftësitë:

- Përgaditja shkollore e mesme;
- Përvoja e kërkuar e punës: së paku 2 vite përvojë pune;
- Shkathësi të shkelqyeshme të komunikimit në gjuhën zyrtare.

Dokumentet e kërkuara:

- Dëshmia përkatëse për posedimin e diplomës së shkollës së mesme
- Dëshmi të përvojës së punës
- Dy rekomandime
- Letërnjoftimi
- Ekstrakti nga libri amë i të lindurve
- Çertifikata që nuk jeni nën hetime nga gjykata

Konkursi mbetet i hapur: *15 ditë, prej datës 12.01.2023 deri 27.01.2023.*

Kandidatët e interesuar aplikacionet mund ti marrin në formë fizike, çdo ditë pune, në Qendrën për Shërbime me Qytetar dhe të plotësuara ti dorëzojnë në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, zyra nr.100- kati i parë, në ndërtesën e Komunës.

Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret dhe hynë në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë. Mirëpriten aplikacionet prej meshkujve dhe femrave të të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e pakompletuara refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të njoftohen për vendin, datën dhe kohën e mbajtjes së testimit me gojë përmes Web faqes zyrtare të komunës dhe tabelës së shpalljeve publike të Komunës.

Rezultatet shpallen në web faqe e komunës dhe tabelen e shpalljeve.

për E emëruar Menaxhere e Personelit
Zize Bujupaj

